



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6191 prot.

Ballsh më, 26.12.2024

VENDIM

Nr. 63 Datë 24/12/2024

“PËR
MIRATIMIN E E PAGESËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË EFEKTIV
(INSTRUKTOR) NË SHKOLLAT E ARSIMIT FILLOR DHE TË MESËM TË ULËT QË
KRYEJNË ORË MËSIMI SHITESË PËR VITIN MËSIMOR 2024-2025, BASHKIA
MALLAKASTËR ”

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mallakastër nr. 65, datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”, VKM nr. 425, datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”,

VENDOSI

1. Miratimin e pagesës në masën 300 (treqind) lekë / orë të punonjësve mësimorë efektiv (instruktur) në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, që për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën e lejuar mësimore për vitin mësimor 2024-2025.
2. Shpenzimet do të mbulohen nga nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, artikulli 602.
3. Efektet finaciare fillojnë nga data 09.09.2024.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

